



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME




СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Mekanizmat Institucionalë Për Zbatimin E Kodit Të Sjelljes (Pasqyra Krahase) Britania E Madhe Republika E Maltës Republika E Shqipërisë Republika E Gjeorgjisë SHBA



Имплементирано од:





IMPRESUM:

Titull: Mekanizmat Institucionalë Për Zbatimin E Kodit Të Sjelljes
(Pasqyra Krahaseuese) Britania E Madhe, Republika E Maltës, Republika E Shqipërisë, Republika
E Gjeorgjisë, SHBA

Botues: Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN)

Rreth botuesit: Drejtoreshë Ekzekutive e QMN-së, Neda Maleska Saçmaroska

Autor: Ekipi i QMN-së

Redaktor: Neda Maleska Saçmaroska

Dizajni: Marko Danailovski

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023



Ky dokument është hartuar në kuadër të Programit të Mbështetjes Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP-ja zbatohet nga Instituti Demokratik Nacional (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCSH) dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (QMN). Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e SDC-së.

2 | Mekanizmat institucionalë për zbatimin e Kodit të Sjelljes, Pasqyra krahasuese, për gatitur nga Qendra për menaxhim me ndryshime (QMN) në kuadër të Programit për mbështetje parlamentare



PËRMBAJTJA

PASQYRA KRAHASUESE	5
1. BRITANIA E MADHE.....	6
1.1 Mekanizmat institucionalë.....	6
1.1.1 I autorizuari i standardeve	6
1.1.2 Komiteti i Standardeve.....	7
1.2 Regjistrat për interesat financiare dhe interesat e tjerë të deputetëve dhe partive	7
1.3 Parashtrimi i ankesës për shkeljen e KS-së.....	8
1.4 Sanksionet për shkeljen e Kodit të Sjelljes.....	8
2. REPUBLIKA E MALTËS	8
2.1 Mekanizmat institucionalë.....	8
2.2 Regjistrat për interesat financiare dhe interesat e tjerë të deputetëve dhe partive	11
2.3 Parashtrimi i ankesës për shkeljen e KEDHP-së	11
2.4 Sanksionet për shkeljen e KEDHP-së dhe LSJP-së.....	12
3. REPUBLIKA E SHQIPËRISË	12
3.1 Mekanizmat institucionalë.....	12
3.1.1. Byroja e Kuvendit.....	13
3.1.2. Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Çështjeve të Imunitetit	13
3.2 Regjistrat për interesat financiare dhe interesat e tjerë të deputetëve dhe partive	14
3.3 Parashtrimi i ankesës për shkeljen e KS-së.....	15
3.4 Sanksionet për shkeljen e KS-së	15
4. REPUBLIKA E GJEORGJISË	16
4.1 Mekanizmat institucionalë.....	16
4.1.1 Këshilli i Etikës	17
4.2 Regjistrat për interesat financiare dhe interesat e tjerë të deputetëve dhe partive	18
4.3. Parashtrimi i ankesës për shkeljen e KS-së	18
4.4 Sanksionet për shkeljen e KS-së	19
5. SHBA	20
5.1 Mekanizmat institucionalë.....	20
5.1.1 Komiteti i Etikës në Dhomën e Përfaqësuesve	20
5.1.2 Komisioni i Etikës në Kongres	21
5.1 Regjistrat e deklaratave / raporteve financiare.....	23



5.1 Parashtrimi i ankesës	23
5.4 Sanksionet për shkeljen e KSZ	24



PASQYRA KRAHASUESE

Pasqyra krahasuese e "Mekanizmave institucionalë për zbatimin e Kodit të Sjelljes" i prezantuar në këtë dokument, i mori parasysh modelet ekzistuese strukturore të Dhomave Ligjvënëse të Britanisë së Madhe, Republikës së Maltës, Republikës së Gjeorgjisë, Republikës së Shqipërisë dhe SHBA-së. Nga krahasimi, së pari del - kontrasti i fuqishëm: saktësia e mekanizmit etik kompleks të traditave të vjetra, shoqërore-politike liberale, në krahasim me përpjekjet pak a shumë të formalizuara për të tejkaluar "tjetërsinë dhe egoizmin" e të zgjedhurve të popullit nga të a.q. - demokracitë tranzitore.

Saktësia e mekanizmit etik në Dhomën Ligjvënëse, në radhë të parë do të thotë: - rregullat e përcaktuara etike në mënyrë të qartë, të zyrtarizuara në - kod; - ndarja e qartë e përgjegjësi ndërmjet organeve interne që zbatojnë kodin e kontraktuar; - mundësia e hapur për të parashtruar ankesë; - përcaktimi i sanksionit përkatës për sjelljen joetike të dëshmuar; - opsioni për mbikëqyrjen llogaridhënëse konkrete para publikut profesional. Por, e gjithë kjo, pa marrë parasysh sa qëllimshme është, nuk do të kishte kuptim, nëse personi - "deputeti i popullit" - në thelb, i mungon vetëdija dhe vetëndjenja se sipas procesit zgjedhor politik i është dhënë mandat i kufizuar për t'i përfaqësuar interesat e qytetarëve që i besuan për t'ia dhënë pozitën e tillë të përkohshme dhe kalimtare - të privilegjuar shoqërisht, por të pandashme nga përgjegjësia personale.

Në përgjithësi, tregohet se - efikasiteti i mekanizmit të institucionalizuar për parandalimin dhe / ose korrigjimin e sjelljes joetike në Dhomën Ligjvënëse lidhet drejtpërdrejt - me fushën dhe me thellësinë e memories shoqërore, e cila, nga ana tjetër, sistemin e saj të vlerës e tërheq nga përvoja historike për vendosjen e nocionit - "shtet", por në të njëjtën kohë, varet edhe nga prekja reale, nga marrëdhëniet ekzistuese me traditën politike në atë shtet, që do të thotë edhe nga gatishmëria e nevojshme - mekanizmi korrigjues etik për t'u përshtatur vazhdimisht me ndryshimet, ritmi i së cilës, nga ana tjetër, dikton kryesisht zhvillimin teknik-teknologjik (p.sh. - shpejtësia e shkëmbimit dhe verifikueshmërisë së të dhënave) dhe sfidat ekonomike (p.sh. - lobimi lokal dhe / ose global). Në çdo rast, përmes relacioneve politike komplekse, si kujdes kryesor për kurthin etik të - "tjetërsimit dhe egoizmit" të deputetëve të popullit, tregohet ekzistimi i rrjetit të gjerë të korrektorëve etikë me vetëdije të theksuar të nocioneve - "interesi publik" / "e mira publike", rrjeti i ndërthurur dendur - nga publiku profesional, akademik, nga organizatat civile, por edhe nga individët e respektuar të cilët me shembullin personal, e dëshmuar moralin dhe pavarësinë e tyre politike përmes aktiviteteve konkrete në kuadër të komunitetit të caktuar shoqëror.



1. BRITANIA E MADHE

1.1 Mekanizmat institucionalë

Kodi i Sjelljes në Dhomën e Poshtme të Parlamentit të Britanisë së Madhe zbatohet përmes koordinimit të kompetencave midis - të autorizuarit të standardeve dhe Komitetit të Standardeve. Modeli, përmes të cilit Dhoma Ligjvënëse institucionalisht e vendos dhe e garanton rendin etik të kontraktuar, standardizon - mundësinë e parashtrimit të ankesës dhe strukturën e përpunuar të sanksioneve përkatëse për sjelljen joetike, si dhe mënyrat e komunikimit të hapur me publikun.

1.1.1 I autorizuari i standardeve

Mbikëqyrja e (mos)respektimit të Kodit të Sjelljes (KS) kryhet nga - i autorizuari i standardeve, nëpunësi i pavarur i zgjedhur për mandat pesëvjeçar nga Dhoma e Poshtme e Parlamentit.

I autorizuari është përgjegjës:

- të japë këshilla / interpretime të Kodit të Sjelljes (KS);
- të hetojë konstatime nga ankuesi për shkeljen e mundshme të KS-së nga deputeti;
- ta njoftojë ankuesin dhe ta ftojë deputetin për t'iu përgjigjur konstatimeve;
- të hetojë konstatime për ofendime, për "ngacmime" dhe / ose shqetësim seksual në kuadër të Dhomës së Poshtme të Parlamentit;
- të vendosë në mënyrë të pavarur, por në kohën e duhur të njoftojë Komitetin e Standardeve që një rast i caktuar mund të zgjidhet me kërkimfalje me shkrim të dorëzuar nga deputeti në fjalë, ndërsa njoftimi të publikohet në faqen e internetit të të autorizuarit;
- të monitorojë nevojën për të përshtatur përmbajtjen e KS-së;
- t'i mbajë regjistrat për përfitime financiare dhe përfitime të tjera;
- të jap raport në Komitetin e Standardeve.

I autorizuari nuk është përgjegjës:

- për mënyrat e komunikimit individual të deputetëve me publikun;
- për paraqitjet individuale të deputetëve në punën e Parlamentit;
- për veprat penale të kryera nga deputeti.



1.1.2 Komiteti i Standardeve

Komiteti i Standardeve përbëhet nga 7 deputetë të zgjedhur nga Dhoma e Poshtme dhe 7 personalitete publike (4 femra dhe 3 meshkuj) profesionistë të dëshmuar me fushëveprim kryesisht (por jo ekskluzivisht) nga të drejtat e njeriut, të zgjedhur në konkurs publik të shpallur nga Dhoma e Poshtme e Parlamentit. Ideja themelore është që anëtarët të përfaqësojnë sa më shumë të jetë e mundur fushën e "komunave" (vetëqeverisjeve lokale) dhe veprimtarive publike të shtetit, ndërsa detyra e tij kryesore është të mbikëqyrë punën e të autorizuarit të standardeve.

Komiteti është përgjegjës:

- të mbikëqyrë punën e të autorizuarit;
- t'i shqyrtojë raportet në lidhje me (mos)respektimin e KS-së të parashtuara nga i autorizuari;
- të prononcohet (sipas nevojës) për përmbajtjen e ndonjë prej raporteve;
- të diskutojë për raste të caktuara të kontroverseve financiare dhe kontroverseve të tjera;
- të ftojë në prononcim intern deputetin ose liderin e partisë;
- të diskutojë për raste të tjera të shkeljes së KS-së për të cilat njofton i autorizuari;
- të propozojë, (sipas nevojës) ndryshime të KS-së;
- të vendos me konsensus, edhe pse lejohet shtimi i të a.q. "mendimi i veçantë";
- të publikojë konkluzionin në faqen e vet të internetit.

1.2 Regjistrat për interesat financiare dhe interesat e tjerë të deputetëve dhe partive¹

Për përfitimet financiare (donacionet, honoraret, çmimet, dhuratat, etj.) dhe për përfitimet e tjera që i kanë marrë ose i marrin deputetët individualisht, ose grupe të caktuara parlamentare dhe / ose parti, por edhe kuadri i gazetarëve të ngarkuar me punën e Kanalit të Parlamentit - mbahen regjistra të veçantë. Regjistrat janë në dispozicion publikisht në faqen e internetit të Dhomës së Poshtme të Parlamentit, ndërsa për mirëmbajtjen e tyre është i ngarkuar i autorizuari i standardeve. Mënyra në të cilën deputeti ose partia njofton për përfitimin e marrë (financiar) përshkruhet me Rregulloren e veçantë.

<https://www.parliament.uk/mps-lords-and-offices/standards-and-financial-interests/parliamentary-commissioner-for-standards/registers-of-interests/register-of-members-financial-interests/#:~:text=The%20main%20purpose%20of%20the,as%20a%20Member%20of%20Parliament.>

7 | Mekanizmat institucionalë për zbatimin e Kodit të Sjelljes, Pasqyra krahasuese, për gatitur nga Qendra për menaxhim me ndryshime (QMN) në kuadër të Programit për mbështetje parlamentare



1.3 Parashtrimi i ankesës për shkeljen e KS-së

Ankesat duhet:

- të parashtrohen nga individ, qoftë deputet, qoftë person jashtë Parlamentit;
- të jenë në formë me shkrim, të nënshkruara dhe të përmbajnë emrin dhe mbiemrin e plotë të ankuesit dhe adresën e tij të plotë postare;
- të raportojnë qartë dhe me argumente në lidhje me shkeljen e mundshme të KS-së;
- të dërgohet kopja e ankesës te deputeti në fjalë.

1.4 Sanksionet për shkeljen e Kodit të Sjelljes²

Komiteti i Standardeve punon vazhdimisht në rishqyrtimin e llojeve të sanksioneve për deputetët që e shkelën KS-në, duke pasur parasysh efektivitetin dhe zbatueshmërinë e sanksioneve në lidhje me peshën e shkeljes së kryer. Fushëveprimi i sanksionit varion: nga kërkimfalja me gojë ose me shkrim - me urdhër të Komitetit, deri te - mospagimi i rrogës, përjashtimi ose largimi nga puna e Dhomës së Poshtme të Parlamentit - me propozim të Komitetit, ndërsa me vendim të Dhomës.

Nga deputeti për të cilin mbahet procedura për shkeljen e KS-së kërkohet të bashkëpunojë plotësisht me organet interne kompetente - me të autorizuarin dhe me Komitetin. Përpjekja e deputetit për të lobuar te ndonjë nga anëtarët e Komitetit - konsiderohet shkelje shumë serioze e standardeve etike, ndërsa rastet e tilla zakonisht përfundojnë me propozim për të pezulluar deputetin nga puna e Dhomës së Poshtme.

2. REPUBLIKA E MALTËS

2.1 Mekanizmat institucionalë

Përmbajtja e Kodit Etik të Deputetëve në Parlamentin e Republikës së Maltës rrjedh nga Ligji për standardet e jetës publike, ndërsa procedura për vlerësimin e sjelljes joetike të deputetit, ministrit dhe / ose nëpunësit publik mbahet nga i autorizuari i standardeve dhe Komiteti i Përhershëm i Standardeve në Jetën Publike. Modeli është i hapur për publikun si korrektor i mundshëm etik, kështu që parashikon mundësi për të parashtruar ankesë tek i autorizuari, zyra e të cilit, pas zbatimit të hetimit, harton raport që ia prezanton Komitetit, i cili miraton vendim përfundimtar, sanksione dhe / ose masa disiplinore.

https://publications.parliament.uk/pa/cm5801/cmselect/cmstandards/241/24104.htm#_idTextAnchor003

8 | Mekanizmat institucionalë për zbatimin e Kodit të Sjelljes, Pasqyra krahasuese, për gatitur nga Qendra për menaxhim me ndryshime (QMN) në kuadër të Programit për mbështetje parlamentare



2.1.1 I autorizuari i standardeve

I autorizuari i standardeve në jetën publike (më tutje - AS) emërohet për mandat pesëvjeçar - pa të drejtë rizgjedhjeje, me të drejtë dorëheqjeje - nga Presidenti i Republikës së Maltës, bazuar në rezolutën e miratuar nga Parlamenti (Dhoma e Përfaqësuesve) me të paktën dy të tretat e përbërjes së përgjithshme parlamentare, e cila në të njëjtën procedurë, ndërsa me rrethana të caktuara, mund të ndryshojë AS-në përpara se t'i skadojë mandati. Për këtë pozicion shoqëror, AS-ja jep betim para Kryetarit të Parlamentit, funksionon kryesisht në bazë të "Kodit Etik të Deputetëve në Dhomën e Përfaqësuesve" (më tutje - KEDHP), versioni i parë i të cilit ishte miratuar në vitin 1995, por pavarësisht kësaj rregullative, AS-ja është kompetent edhe për rastet e sjelljes joetike në lidhje me rregullat e "Kodit të ministrave dhe sekretarëve të Parlamentit" dhe "Kodit të të autorizuarve". Konteksti juridik për përmbajtjen e KEDHP-së rrjedh drejtpërdrejt dhe në mënyrë mjaft të qartë nga - Ligji për standardet e jetës publike (LSJP), ndërsa tërthorazi nga - Ligji për administratën publike (Kapitulli 595 i legjislacionit të Republikës së Maltës).³⁴

Zyra e AS-së (objekti është i përbashkët me Zyrën e Avokatit të Popullit) përbëhet nga: - drejtori i përgjithshëm; - ndihmësdrejtori (përgjegjës për kërkimin dhe komunikimin); - hetuesi - analisti i kërkimeve; - udhëheqësi i Zyrës dhe dy të punësuar si personal ndihmës. Shpenzimet për pajisjen e Zyrës, mbështetjen financiare për hetimet, si dhe rrogën për AS-në (në shkallën e të ardhurave mujore të gjykatësit kushtetues) dhe për të punësuarit e Zyrës së tij - sigurohen nga buxheti vjetor i Parlamentit të Republikës së Maltës, me ç'rast më 15 shtator çdo vjet, AS-ja parashtron raport financiar në Parlament për punën e tij.

Sipas rregullave të LSJP-së, për AS-në nuk mund të caktohet:

- deputeti në përbërjen aktuale të Parlamentit;
- këshilltari në vetëqeverisjen lokale;
- nëpunësi publik;
- personi, shërbimi ose pozicioni i të cilit bie ndesh me LSJP-në;
- anëtar i sindikatës zeytare, bankare, tregtare ose sindikatës tjetër me pozicion pune të paguar;

Juridiksioni i AS-së është përcaktuar në detaje në LSJP-në, dhe përfshin mbikëqyrjen, përkatësisht hetimet e shkeljeve të mundshme të KEDHP-së ose ligjit, ose rastet e keqpërdorimit të pozicionit të fuqisë politike nga:

<https://www.parlament.mt/en/menues/about-parliament/code-of-ethics/members-of-parliament/>

<https://parlament.mt/en/12th-leg/acts-12th/act-xiii-of-2017/> (tekstet e të gjitha kodeve të mësipërme janë pjesë komplementare të tërësisë së - Ligjit për standardet e jetës publike)



- deputetët, sekretarët e Parlamentit dhe ministrat;
- të autorizuarit (personat jashtë administratës shtetërore, në shërbim të këshilltarëve ose si të punësuar në sekretariatet e ministrive dhe në sekretariatin e Parlamentit, ose si nëpunës në zëvendësim në vendet e lira të administratës publike).

I autorizuari i standardeve mund të hapë procedurë hetimore me iniciativën e tij ose në bazë të ankesës / parashtresës. Sidoqoftë, AS-ja nuk mund të hetojë raste të sjelljes joetike të kryera para 30 tetorit 2008, datë kur në fuqi hyri LSJP-ja, as nuk mund të hetojë raste që janë lëndë e ndjekjes penale ose janë tashmë në procedurë policore. Nëse AS-ja konstaton se deputeti, ministri, sekretari në Parlament ose i autorizuari qeveritar ka kryer shkelje të ligjit ose të KEDHP-së, atëherë ia komunikon gjetjet personit në fjalë dhe i jep kohën e nevojshme për të përgatitur mbrojtje juridike. AS-ja mund të hartojë raport që më pas në Parlament e parashtron përpara Komitetit të Përhershëm të Standardeve në Jetën Publike. AS-ja në procedurën hetimore mund të angazhojë persona profesionistë si konsulentë të jashtëm, dhe nëse personi profesionist i nevojshëm është nëpunës publik, atëherë për angazhimin e tij duhet të kërkojë miratimin nga Kryeministri.

Në kontekstin e tri kodeve përkatëse të sjelljes të përmendura më lart, ndërsa në shtojcë të punës së tij, AS-ja mund të kontrollojë edhe saktësinë e të dhënave në "listat anketuese", respektivisht - deklaratat e interesit financiar ose konfliktit të interesave që i parashtrojnë deputetët dhe ministrat. AS-ja mund të japë rekomandime për përmirësimin e teksteve të disa prej kodeve etike, si dhe rregullativave për lobimin dhe për pranimin e dhuratave.

2.1.2 Komiteti i Përhershëm i Standardeve në Jetën Publike

Ligji për standardet në jetën publike është baza për vendosjen e Komitetit të Përhershëm të Standardeve në Jetën Publike (më tutje KPS) brenda Parlamentit të Republikës së Maltës. Përbëhet nga katër anëtarë / deputetë: dy nga shumica qeveritare dhe dy nga opozita. Kryesues i tij është Kryetari i Parlamentit, vota e të cilit është vendimtare në rastet e votimit baraz. KPS-ja është komiteti i vetëm parlamentar me numër të barabartë të përfaqësuesve të pushtetit dhe opozitës. Roli i KPS-së është të mbikëqyrë punën e AS-së, përkatësisht t'i shqyrtojë raportet që AS-ja i parashtron pas hetimit të kryer për sjelljen joetike.



2.2 Regjistrat për interesat financiare dhe interesat e tjerë të deputetëve dhe partive⁵

Të mbajtur nga Kryetari i Parlamentit, të disponueshëm publikisht përmes faqes së internetit të Parlamentit, janë:

- Regjistri për interesat financiare të deputetit (lloji - "lista anketuese") - që parashtrohet një herë në vit dhe përmban të dhëna për: - veprimtarinë profesionale të paramandatit të deputetit; - identitetin e punëdhënësit të tij; - pronën e patundshme të deputetit, duke përfshirë edhe pronën e familjes së tij; - aksionet dhe / ose pozicionet e drejtorit dhe pozicionet e tjera zyrtare në firmat, në këshillat drejtues të organizatave komerciale dhe jokomerciale; - investimet; - depozitat bankare, etj;
- Regjistri i deklaratave të konfliktit të mundshëm të interesave - deklaratat e detyrueshme të cilat janë dhënë para fillimit të debatit parlamentar për ligj të caktuar;
- Regjistri i deklaratave për udhëtimet e bëra jashtë Maltës - tërësisht ose pjesërisht të financuar nga grupi, kompania ose individ, ndërsa drejtpërdrejt e prekin legjislacionin e Republikës së Maltës;

Në mënyrë plotësuese, deputeti është i detyruar të njoftojë me kohë qoftë Kryetarin e Parlamentit, qoftë institucionin shtetëror përkatës, në rastet kur pala e tretë i bën presion atij për sjellje joetike dhe / ose përpjekje për korrupsion.

2.3 Parashtrimi i ankesës për shkeljen e KEDHP-së

Ankesa, kundër të gjithë atyre që preken me dispozitat e LSJP-së, mund të parashtrohet nga kushdo, ndërsa parashtrohet tek AS-ja me letër ose me formular elektronik, duke theksuar identitetin e plotë të parashtruesit, dhe nëse ai dëshiron të mbetet anonim, kjo duhet t'i theksohet veçmas AS-së. Në ankesë duhet të theksohet identiteti i plotë i ankuesit, me arsyetim të shpjeguar shoqërues për sjelljen e mundshme joetike ose për shkeljen e kryer. Në raste të jashtëzakonshme, ankesa mund të parashtrohet edhe me gojë, por më pas duhet të bëhet transkripti që deklaratë zyrtare do të harmonizohet dhe do të konfirmohet më së voni brenda dhjetë ditësh. Përmes numrit zyrtar të telefonit të zyrës së AS-së për rastet e tilla caktohet takimi, qoftë personalisht me AS-në, qoftë me ndonjë nga nëpunësit kompetentë.

<https://www.parliament.uk/mps-lords-and-offices/standards-and-financial-interests/parliamentary-commissioner-for-standards/registers-of-interests/register-of-members-financial-interests/#:~:text=The%20main%20purpose%20of%20the,as%20a%20Member%20of%20Parliament.>

11 | Mekanizmat institucionalë për zbatimin e Kodit të Sjelljes, Pasqyra krahasuese, për gatitur nga Qendra për menaxhim me ndryshime (OMN) në kuadër të Programit për mbështetje parlamentare



Gjatë parashtrimt të ankesës, duhet të merret parasysh afati kohor, përkatësisht - AS-ja nuk mund të hetojë vepra të sjelljes joetike të kryera para 30 tetorit 2008, data kur në fuqi hyri LSJP-ja. Ankesa parashtrohet brenda tridhjetë ditëve të punës nga njoftimi i parë i sjelljes joetike, ose më së voni një vit pasi vepra është kryer në të vërtetë. Jashtë këtyre datave - AS-ja nuk e merr parasysh ankesën. Gjithashtu, AS-ja nuk shqyrton ankesa që janë tashmë lëndë e procedurës rrjedhëse gjyqësore ose procedurës përpara tribunalit, pastaj proceseve përpara gjykatave për kundërvajtje ose rasteve të hetimit në kompetencë të policisë.

AS-ja ka të drejtë të refuzojë ankesë, për të cilën e njofton parashtruesin me arsyetim me shkrim, nëse konsideron se ankesa është: - e pabazuar; - e parëndësishme; - arbitrare; - e pajustificueshme dhe / ose qëllimkeqe.

2.4 Sanksionet për shkeljen e KEDHP-së dhe LSJP-së

Sanksionet ose masat disiplinore për sjellje joetike të atyre që preken drejtpërdrejt nga dispozitat e LSJP-së zbatohen ekskluzivisht nga Komiteti i Përhershëm i Standardeve në Jetën Publike (KPS). Vendimet për procedurat e tilla, KPS-ja kryesisht i bazon në konstatimet e hetimeve të përfshira në raportin e AS-së.

Nëse KPS-ja e miraton raportin nga AS-ja, atëherë mund t'i lëshojë paralajmërim ose kërkesë për falje zyrtare për deputetin, ministrin, sekretarin e Parlamentit, nëpunësve të tjerë parlamentarë dhe të autorizuarve që kanë kryer akt joetik, por mundet edhe, në varësi të përmbajtjes dhe peshës së shkeljes, të parashtojë kërkesë në institucionet shtetërore përkatëse, përfshirë edhe Parlamentin, për zgjidhjen e mëtejshme juridike dhe konsekuente të shkeljes. Nëse, nga ana tjetër, KPS-ja nuk pajtohet me konstatimet e raportit të AS-së, atëherë mund të vendosë që procedura të vazhdojë me hetim të mëtejshëm të cilin KPS-ja mund t'i kërkojë AS-së ta zbatojë në mënyrë të pavarur, ose KPS-ja ta zbatojë me ndihmën e AS-së. Në raste të tjera, KPS-ja mund të refuzojë raportin e AS-së tërësisht, por më pas duhet të arsyetojë publikisht pse ka miratuar një vendim të tillë.

3. REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3.1 Mekanizmat institucionalë

Institucionalisht, procesi për të kontrolluar shkeljen e mundshme të Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë është inert, përkatësisht kompetencat koordinohen ndërmjet - Byrosë së Kuvendit dhe Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit. Ankesë për sjellje joetike të deputetit, në Byro mund të parashtojë deputeti, grupi parlamentar, por edhe përfaqësuesi i publikut të gjerë. Pas raporteve nga hetimet e Byrosë dhe Këshillit, Parlamenti përcakton sanksione përkatëse / masa disiplinore, të parashikuara dhe të përcaktuara në Rregulloren e Punës së Kuvendit.



3.1.1. Byroja e Kuvendit

Byroja e Kuvendit (BK) është organi kompetent për zbatimin e Kodit të Sjelljes (KS). BK-ja është organ, fushëveprimi kryesor i të cilit janë puna e pavarur administrative dhe financiare e Kuvendit. Ka 10 anëtarë, kryesues është Kryetari i Kuvendit, ndërsa anëtarët e tjerë janë - zëvendëskryetari i Kuvendit dhe përfaqësuesit e sekretariateve parlamentare.

Pas takimit të punës me Sekretariatit e Procedurave, Votimit dhe Etikës (i përbërë nga 5 anëtarë të emëruar nga Kuvendi me votim të hapur, me propozim të Kryetarit të Kuvendit dhe pas konsultimeve me kryetarët e grupeve parlamentare), BK-ja mund të analizojë raste specifike të sjelljes së deputetit të caktuar, në lidhje me:

- keqpërdorimin e pozitës politike, ndërsa kundër nderit dhe reputacionit të deputetit si përfaqësues i Kuvendit;
- dorëzimin e formularëve të gabuar për gjendjen financiare dhe për llojin tjetër të përfitimit sipas KS-së;
- nxitjen e formave joetike të keqpërdorimit të votuesve.

3.1.2. Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Çështjeve të Imunitetit

Evalvimi, që do të thotë - (ri)vlerësimi dhe revidimi periodik i KS-së, i është besuar - Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit (KRRMI) - trup këshillëdhënës për çështjet që lidhen me procedurën me të cilën Kuvendi funksionon dhe miraton vendime. Në mënyrë që të sigurohet përfaqësimi i barabartë midis shumicës parlamentare dhe pakicës në KRRMI, Kryetari i Kuvendit, si kryesues i tij, emëron 10 deputetë sipas mendimit të marrë nga kryetarët e grupeve parlamentare.

KRRMI-ja, për të vlerësuar përshtatshmërinë dhe ndikimin që kanë standardet etike ekzistuese të KS-së në aktivitetin politik parlamentar të deputetit, shqyrton:

- edhe materialet e veçanta dhe raportet vjetore të BK-së, në lidhje me rastet e shkeljes së KS-së, si dhe masat disiplinore të marra kundër deputetëve për këto shkelje;
- përshkrimet e rasteve të shkeljes së KS-së gjatë mandatit legjislativ;
- regjistrin e masave disiplinore;
- jurisprudencën shqiptare, si dhe ndryshimet në legjislacionin shqiptar për çështjet e përfshira me KS-në;
- praktikën ndërkombëtare për këto çështje.

KRRMI-ja harton raport mbi këto detyra, i cili prezantohet në seancën plenare, por raporti nuk është lëndë e diskutimit të mëtejshëm parlamentar, por miratohet nga Kuvendi jo më vonë se një muaj pas prezantimit, ndërsa nëse është e nevojshme të merret iniciativa për plotësimin ose ndryshimin në KS, atëherë iniciativa paraqitet në sesionin parlamentar, së bashku me vlerësimin vjetor dhe me rekomandimet relevante. Në bazë të raportit të KRRMI-së, secili deputet ose grup parlamentar mund të iniciojë ndryshime në KS. Menjëherë pas miratimit të raportit, Kryetari i Kuvendit urdhëron që të publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit, në mënyrë që është i disponueshëm lehtë për publikun.

Më së voni tetë muaj para skadimit të mandatit të përbërjes parlamentare, Kryetari i Kuvendit konvokon mbledhje të KRRMI-së në të cilën janë të ftuar edhe përfaqësuesit e organizatave civile dhe grupeve të interesit, të evidentuar në regjistrin e veçantë parlamentar për lobim në favor të shoqërisë civile.

3.2 Regjistrat për interesat financiare dhe interesat e tjerë të deputetëve dhe partive⁶

Shërbimet e Kuvendit mbajnë një sërë regjistrash për veprimtari të ndryshme, por përse i përket KS-së një nga më të rëndësishmit është - Regjistri i konfliktit të interesave, i cili azhurnohet një herë në vit, ndërsa është i organizuar sipas listës së përbërjes aktuale dhe përbërjes së kaluar parlamentare.

Regjistri i përmban këto të dhëna:

- emrin e personit fizik ose juridik me të cilin deputeti ka kontratë juridike civile ose ndonjë lidhje tjetër me personat fizikë ose subjektet që ka rezultuar me gjenerimin e të ardhurave për deputetin dhe që paraqet konflikt të vazhdueshëm;
- të drejtat mbi kapitalin e kompanive në pronësi të bashkëshortit / partnerit, fëmijëve të rritur dhe prindërve të deputetit, ndërsa të cilat mund të paraqesin kufizim të aktiviteteve tregtare;
- deklaratën me shkrim të deputetit në lidhje me konfliktin e interesave për çështje të caktuara të diskutuara në Dhomën Ligjvënëse, ose derisa ai ishte deputet;
- mandatin ose periudhën në të cilën personi ishte deputet (në rast se deputeti nuk ka arritur të mbetet deputet gjatë mandatit të plotë).
- përshkrimin e shkurtër të natyrës së konfliktit të interesave;
- vendimet e BK-së për masat disiplinore të marra kundër deputetit dhe që lidhen me gjendjen e konfliktit të interesave (nëse ka);
- në bashkëngjitje dorëzohet edhe formulari i deklaratës në lidhje me konfliktin e përkohshëm të interesave.

<https://www.parliament.uk/mps-lords-and-offices/standards-and-financial-interests/parliamentary-commissioner-for-standards/registers-of-interests/register-of-members-financial-interests/#:~:text=The%20main%20purpose%20of%20the,as%20a%20Member%20of%20Parliament.>

BK-ja është adresa e fundit meritorë për rastet kur ndonjë deputet i caktuar nuk ka raportuar fare ose ka raportuar jo në kohë rastin e konfliktit të interesave derisa procedurat janë duke u zhvilluar për diskutimin mbi propozim-ligjin e caktuar. Deklarata për ekzistimin e interesit personal në fushë / diskutim të caktuar legjislativ paraqet formular të veçantë që i dorëzohet Shërbimit për Mbështetjen e Deputetëve, ndërsa për deklaratat e tilla mbahet regjistër i veçantë i publikuar në faqen e internetit të Kuvendit. Me kërkesë të të paktën një grupi parlamentar, BK-ja duhet të shqyrtojë lëndën kontestimore brenda 48 orësh dhe të vlerësojë nëse deputeti po vepron nga pozicioni i konfliktit të interesave. Deklarata e ekzistimit të konfliktit të interesave i përmban këto të dhëna:

- përshkrimin e kontratës ose të statusit civil në përgjithësi që rezulton me gjenerimin e të ardhurave për deputetin;
- emrin e individit, personit fizik ose juridik me të cilin është lidhur kontrata, ose marrëdhënia e deputetit në lidhje me marrëdhëniet juridike civile ose të tjera, në mënyrë që të realizojë të ardhura për deputetin.

3.3 Parashtrimi i ankesës për shkeljen e KS-së

Grupi parlamentar, por edhe organizatat e jashtme dhe / ose individët mund me ankesë t'i drejtohen Kuvendit, në rast se konsiderojnë se sjellja parlamentare dhe / ose jashtëparlamentare e deputetit të caktuar nuk përkon me kërkesat e KS-së, veçanërisht nëse sjellja e tejkalon kufirin e mirësjelljes dhe çon në uljen e besimit publik të Kuvendit si organ shtetëror. Ankesa mund të përbëhet nga përshkrimi me shkrim i rastit, por edhe nga dokumentacioni tjetër shoqërues audio / vizual i bashkangjitur në procedurën e provës.

BK-ja diskuton mbi shkallën e shkeljes së KS-së potencialisht të kryer nga deputeti i caktuar, me ç'rast, për të përcaktuar llojin e sanksionit të mundshëm, të përshkruar në detaje dhe të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit, i merr parasysh edhe të dhënat nga Regjistri i Masave Disiplinore, kryesisht për të përcaktuar nëse deputeti përsërit sjellje të dëmshme për reputacionin publik të Dhomës Ligjvënëse.

3.4 Sanksionet për shkeljen e KS-së

Llojet e ndryshme të sanksioneve, ose - masat disiplinore, parashikohen me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Mund t'i shqiptohen deputetit i cili në mënyra të ndryshme, qoftë verbalisht, qoftë fizikisht, e pengon punën e seancave plenare dhe seancave parlamentare, ose, me sjelljen e tij publike, e dëmton reputacionin e institucionit. Në rastet, për shembull, kur shkelen të a.q. "të drejtat procedurale", ose kur nga foltorja parlamentare shqiptohet "gjuha fyese dhe / ose gjuha e urrejtjes", roli i BK-së në lidhje me atë që përshkruhet nga KS-ja varet nga vendimet / procedurat e mëparshme që kundër shkelësit të Rregullores i merr Kryetari i Kuvendit. Në mënyrë të tërthortë, në fazat e të gjithë procedurës disiplinore, mund të përfshihen edhe Sekretariati Teknik dhe Sekretariati i Procedurave dhe Votimit, nëse është e nevojshme dhe në përputhje me kompetencat e tyre.



Masat disiplinore ndahen në "të lehta" dhe "të rënda", ndërsa kuptimi dhe procedura për zbatimin e secilës masë veç e veç - janë shtjelluar dhe shpjeguar në detaje në Rregulloren e Kuvendit.

Në "masat e lehta", pa të drejtë ankese, parashihen:

- përjashtimi i përkohshëm nga diskutimi parlamentar;
- paralajmërimi;
- marrja e së drejtës për të folur gjatë seancës plenare ose mbledhjes së komisionit;

Në "masat e rënda", me të drejtë ankese, përfshihen:

- përjashtimi nga seanca plenare, nga mbledhja e komisionit ose trupit tjetër të Kuvendit;
- përjashtimi deri në 10 ditë nga pjesëmarrja në seancën plenare, nga komisionet parlamentare dhe nga trupat e tjerë të Kuvendit;

Për shembull, incidenti i caktuar mund të kalojë me paralajmërim me gojë të deputetit, por nëse ajo masë disiplinore rezulton joefikase, atëherë Kryetari i Kuvendit miraton vendim për përjashtimin e deputetit nga sesioni, duke formuluar vendimin në lëndë të veçantë interne që e prezanton përpara BK-së, zakonisht me rekomandim për masa më të rrepta disiplinore. Vendimet e BK-së në bazë të shkeljes së KS-së janë publikuar në faqen e internetit të Kuvendit.

4. REPUBLIKA E GJEORGJISË

4.1 Mekanizmat institucionalë⁷

Këshilli i Etikës është organ kompetent për zbatimin e Kodit të Sjelljes brenda Parlamentit të Republikës së Gjeorgjisë. Këshilli punon me iniciativën e tij ose me ankesë, të parashtruar, qoftë individualisht nga deputeti, qoftë nga grup parlamentar, por edhe nga qytetari i cili konsideron se në dëm të tij është shkelur norma etike e KS-së. Vërejtja kryesore në lidhje me Kodin ekzistues është se, përveç zbulimit publik të identitetit të shkelësit, nuk parashikon sanksione për sjelljen joetike të deputetëve.

<http://www.parliament.ge/en/kanonmdebloba/reglamenti.htm>



4.1.1 Këshilli i Etikës⁸

Këshilli i Etikës (KE) është trup brenda Parlamentit të Gjeorgjisë, që është kompetent për mbikëqyrjen e (mos)zbatimit të dispozitave të Kodit të Sjelljes. Komisioni për Çështjet Procedurale dhe Rregulloren e Parlamentit i përcaktojnë kuotat për përfaqësimin proporcional të partive në përbërjen e KE-së, më së voni një javë pas miratimit të dekretit për përbërjen e re parlamentare. Byroja e Kuvendit i konfirmon kuotat për anëtarët e KE-së, ndërsa mandati zgjat një vit. Organika dhe puna e KE-së përcaktohet nga statuti dhe nga dispozitat e veçanta të KS-së. Për mbështetjen organizative dhe teknike, është formuar Sekretariati i KE-së.

KE-në e mbajnë dy bashkëkryesues, të zgjedhur në mënyrë interne nga anëtarët e tjerë të KE-së - një nga shumica qeveritare dhe një nga partia më e madhe opozitare, por bashkëkryesuesi mund të delegohet edhe nga grupi parlamentar që nuk është i bashkuar as me shumicën qeveritare, as me opozitën. Numri i anëtarëve në KE ndryshon në varësi të shpërndarjes së deputetëve në grupe parlamentare në përbërjen ekzistuese parlamentare aktuale, si dhe nga numri i deputetëve të pavarur. Sidoqoftë, kujdeset që përbërja të shpërndahet në mënyrë proporcionale, përkatësisht - numri i anëtarëve në KE të zgjedhur nga radhët e shumicës qeveritare nuk duhet të jetë më shumë se gjysma, duke marrë parasysh edhe rastet kur deputetët e pavarur në periudhë të caktuar bashkohen me grupin parlamentar të shumicës qeveritare. KE-ja ka të konstatuar Rregulloren e vet të veçantë, ndërsa mbledhjet, të cilat zakonisht janë të mbyllura për publikun, konsiderohen të vlefshme nëse në të marrin pjesë shumica e anëtarëve, me ç'rast vendimet miratohen me votim të fshehtë. KE-ja parashtron raport vjetor për aktivitetet e tij në Parlament.

Në nenin 1 të KS-së theksohet se përmbajtja dhe funksionaliteti i tij bazohen kryesisht në Kushtetutën e Gjeorgjisë, Rregulloren e Parlamentit dhe legjislacionin tjetër shtetëror përkatës. Figura qendrore është deputeti, përkatësisht marrëdhënia e tij me deputetët e tjerë, të punësuarit në Parlament, mediat, institucionet e tjera dhe me publikun në përgjithësi. Neni 4 i KS-së, nga ana tjetër, i mbyllon fushat konkrete që bien nën kompetencën e KE-së dhe i referohen drejtpërdrejt listës së obligimeve etike për deputetin, të detajuar në nenin më parë - nenin 2 të KS-së. Prandaj, KE-ja është kompetent për mbikëqyrjen e sjelljes së deputetit kur:

<http://parliament.ge/ge/ajax/downloadFile/128924/%C3%A1%C6%92%E2%80%9D%C3%A1%C6%92%E2%80%94%C3%A1%C6%92%CB%9C%C3%A1%C6%92%E2%84%A2%C3%A1%C6%92%CB%9C%C3%A1%C6%92%C2%A1%C3%A1%C6%92%E2%84%A2%C3%A1%C6%92%C2%9D%C3%A1%C6%92%E2%80%9C%C3%A1%C6%92%E2%80%9D%C3%A1%C6%92%C2%A5%C3%A1%C6%92%C2%A1%C3%A1%C6%92%CB%9C-english.pdf>



- e keqpërdor pozicionin politik për përfitimin e vet personal dhe / ose përfitimin e familjes së tij dhe të të afërmeve të ngushtë (përkufizimi i këtyre nocioneve është marrë nga Ligji kundër konfliktit të interesave dhe kundër korrupsionit në shërbimin publik);
- nuk parashtron deklaratë me shkrim, e cila publikohet në faqen e internetit të Parlamentit, para fillimit të diskutimit parlamentar në të cilin e dinte se po merrte pjesë me konflikt të mundshëm të interesave;
- nuk paraqet dhuratë / shpërblim në shumën / vlerën e 300 liri gjeorgjiane (rreth 70 euro), për të cilat Sekretariati i KE-së mban Regjistër të veçantë të dhuratave, i disponueshëm në faqen e internetit të Parlamentit;
- lobon gjatë mandatit të tij, edhe pse e di që nuk duhet;
- pranon dhurata / shpërblime nga grupet e lobit, edhe pse e di që nuk duhet;
- nuk njofton për takimet e biznesit me grupet e lobit, dhe nuk parashtron deklaratë në lidhje me takimin e tillë, që publikohet në faqen e internetit të Parlamentit;
- në lidhje me kolegët dhe të punësuarit e tij në Parlament - diskriminon në bazë të - racës, etnisë, gjinisë, besimit fetar ose në bazë të përcaktimeve të tjera personale / kolektive;
- nuk siguron informacion për kontaktin zyrtar personal.

4.2 Regjistrat për interesat financiare dhe interesat e tjerë të deputetëve dhe partive

Për shkak të transparencës së relacioneve eventuale të biznesit të deputetit të caktuar dhe / ose grupit të caktuar parlamentar me ndonjë grup të lobit, në faqen zyrtare të internetit të Parlamentit vendoset i a.q. - Regjistri i grupeve të autorizuar të lobit, në përputhje me Ligjin për aktivitetet e lobimit. Tre regjistrat e tjerë janë - Regjistri për konfliktin e mundshëm të interesave, Regjistri për shkeljen e dispozitave të KS-së dhe Regjistri i dhuratave, i disponueshëm në faqen e internetit të Parlamentit. Të dhënat për këta tre regjistra futen në formularët e veçantë, ndërsa për shembull, formulari për dhuratën e pranuar i përmban të dhënat për: - emrin dhe mbiemrin e deputetit; identitetin e personit fizik dhe / ose personit juridik të dhuruesit; datën e pranimit; përshkrimin e shkurtër dhe vlerën e dhuratës.

4.3. Parashtrimi i ankesës për shkeljen e KS-së

KE-ja punon me iniciativën e vet ose me ankesë, e cila dorëzohet në formular të veçantë - qoftë në formë elektronike, qoftë me kopje fizike, të ngritur qoftë individualisht nga deputeti, qoftë nga grupi parlamentar, por ankesë mund të parashtrorë çdo person që konsideron se në dëm të tij është shkelur ndonjë normë etike e KS-së. KE-ja e pranon ankesën vetëm nëse dorëzohet brenda një muaji pas zbulimit të të dhënës / ngjarjes së caktuar që është shkelje e mundshme e KS-së, e kryer nga deputeti me mandatin rrjedhës. Deputeti të cilit i referohet ankesa informohet menjëherë për përmbajtjen e



ankesës, i jepen 10 ditë pune për të përgatitur përgjigje dhe i jepen edhe 5 ditë shtesë nëse dorëzon letër me shpjegim të arsyeshëm për anulimin e përgjigjes. Në lidhje me ankesën e pranuar zyrtarisht, KE-ja duhet të prononcohet me vendim më së voni në afat prej një muaji. Fillimi i diskutimit mbi ankesën është caktuar më së voni pas 5 ditë pasi të dorëzohet, ndërsa nëse përcaktohet se ankesa nuk është në kompetencë të KE-së, atëherë ankuesi njoftohet me kohë për ta riadresuar në organin përkatës. Nëse normat e KS-së shkelen nga anëtari i KE-së, atëherë atij i merret e drejta për të diskutuar dhe votuar në KE, ndërsa grupi parlamentar që e delegoi përkohësisht e zëvendëson me delegat tjetër, derisa të zbardhet rasti. KE-ja ka autorizime të kërkojë informacione në lidhje me rastin, ndërsa deputeti i dyshuar është i detyruar të bashkëpunojë gjatë gjithë procedurës. Procedurën që e mban KE-ja është konfidenciale, përkatësisht mbledhjet janë të mbyllura për publikun, përveç në rastet kur të dyja palët në KE - shumica qeveritare dhe opozita - nuk vendosin ndryshe. Pa dallim nëse është shkelur ose jo dispozita e KS-së për të cilën është hapur rasti konkret, KE-ja është e detyruar të publikojë informacion në faqen e internetit të Parlamentit, të përbërë nga përshkrimi i shkurtër dhe nga identiteti i deputetit për të cilin është ngritur rasti.

4.4 Sanksionet për shkeljen e KS-së¹⁹

Tani për tani, përveç njoftimit publik të identitetit të shkelësit të dispozitave të KS-së për të cilat KE-ja e ka kompetencën e parë, sanksione të tjera nuk janë parashikuar. Kjo është vërejtja kryesore nga kritikantët e iniciativave civile në lidhje me KS-në ekzistuese. Në rastet e keqpërdorimit të konstatuar financiar ose penal të funksionit deputet, deputeti përgjigjet në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Gjeorgjisë.

<https://www.chemiparlamenti.ge/en/publication/code-ethics-parliament-georgia-not-effective-document>

¹⁹ | Mekanizmat institucionalë për zbatimin e Kodit të Sjelljes, Pasqyra krahasuese, përgatitur nga Qendra për menaxhim me ndryshime (OMN) në kuadër të Programit për mbështetje parlamentare



5. SHBA

5.1 Mekanizmat institucionalë¹⁰

Në Kongresin e SHBA-së - Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve kanë trupa të veçantë të mbikëqyrjes për sjelljen etike të anëtarëve të tyre, të nëpunësve dhe të të punësuarve të tjerë në këto institucione shtetërore. Në vazhdim të tekstit, paraqiten vetëm dy trupa për mbikëqyrjen e sjelljes etike në Dhomën e Përfaqësuesve: - Komiteti i Etikës në Dhomën e Përfaqësuesve (KEDHP) dhe Komisioni i Etikës në Kongres (KEK).¹¹

5.1.1 Komiteti i Etikës në Dhomën e Përfaqësuesve

Komiteti i Etikës në Dhomën e Përfaqësuesve (më tutje në tekst - KEDHP) u formua në vitin 1967, por atëherë me emrin - Komiteti për Standardet e Sjelljes Zyrtare. KEDHP-ja është këshill i përhershëm dhe ka autorizime për të interpretuar, menaxhuar dhe realizuar "Kodin e Sjelljes Zyrtare në Dhomën e Përfaqësuesve" (KSZ), për përmbajtjen e të cilit i trajnon deputetët, nëpunësit dhe të punësuarit në Kongres, dhe është i autorizuar, nëse është e nevojshme, kundër tyre të mbajë hetime dhe të sanksionojë raste të sjelljes joetike. KEDHP-ja pranon parashtresa kundër deputetit në Dhomën e Përfaqësuesve vetëm nëse parashtrohen nga deputeti tjetër. Në këshillin e përhershëm të KEDHP-së delegohen 5 përfaqësues nga republikanët dhe 5 nga demokratët, kryesues tradicionalisht zgjidhet ai që ka më shumë përvojë nga radhët e shumicës qeveritare, ndërsa puna e tij e përditshme kryhet nga nëpunësit jopartiakë, sipas sistematizimit të ndarë në: - këshilltari kryesor; - këshilltari i kryesuesit; - këshilltari i anëtarëve të komitetit; - drejtori i administratës; - drejtori i Departamentit të Hetimeve; - drejtori i deklaratave / raporteve financiare; - drejtori i këshillimit dhe arsimit; - këshilltari i lartë; - këshilltari; - kërkuesi / hetuesi; - nëpunësi dhe personaliteti ndihmës.¹²¹³

Në bazë të Kushtetutës së SHBA-së dhe në bazë të një sërë ligjesh federale, ndërsa sipas dispozitave etike të KSZ-së, vazhdimisht të përshtatur sipas nevojave të momentit shoqëror aktual, KEDHP-ja është e autorizuar të (ri)shqyrtojë konstatime të shkeljes së standardeve etike, rregullave dhe rregullativave, si dhe të japë rekomandime përpara DHP-së ose përpara organeve dhe institucioneve federale përkatëse për veprime të mëtejshme përkatëse për lëndën konkrete të sjelljes joetike të deputetit në DHP, nëpunësit shtetëror ose të punësuarit në Kongres. Prandaj, autorizimet kryesore të KEDHP-së janë këto:

<https://ethics.house.gov/about/committee-history>

Komiteti i Etikës në Senat - <https://www.ethics.senate.gov/public/>

<https://ethics.house.gov/publications/code-official-conduct>

<https://www.govtrack.us/congress/committees/HSSO>

- vendos rregulla që e rregullojnë sjelljen e deputetëve në lidhje me - dhuratat, udhëtimet, aktivitetet në fushatën politike, konfliktin e interesave, marrëdhënien ndaj të punësuarve në Kongres, etj;
- me iniciativën e vet ngrit hetime nëse deputetët në DHP i zbatojnë standardet e KSZ-së;
- jep rekomandime përpara DHP-së në lidhje me veprimin e nevojshëm që do të ndërmerreshin pas hetimit të kryer (për shembull - censura: marrja e fjalës në DHP; dëbimi nga DHP-ja, ose - mosmarrja e veprimeve nëse nuk konstatohet faji moral);
- jep këshilla për deputetët në DHP përpara se të ndërmarrin veprim të caktuar që mund të jetë në kundërshtim me standardet etike;
- përpara organeve dhe institucioneve federale ose shtetërore përkatëse paraqet prova të verifikuara kundër deputetit për të cilin vlerësohet se ka shkelur me shumë gjasë rregullativën e caktuar ligjore.

Si parandalim i sjelljes potencialisht joetike të deputetëve, në strukturën e KEDHP-së funksionojnë: - Këshilltari për konsultime dhe arsim; - Këshilltari për deklarata / raporte financiare; - Këshilltari për hetime të sjelljes së paligjshme - si pozicione këshilluese juridike për të cilat zgjidhen personat jopartiakë përmes konkursit publik; në këtë kornizë strukturore ekziston edhe pozicioni - personali ndihmës, i cili kryesisht merret me mirëmbajtjen e rrjetit të kompjuterit dhe rrjetit të komunikimit të KEDHP-së.

Hetimet që i mban KEDHP-ja përbëhen nga metodat dhe teknikat e kryqëzuara që fillimisht përcaktojnë vlefshmërinë e konstatimeve për shkeljen e mundshme të KSZ-së, dhe më pas përgatisin argumentimin në bazë të të cilit propozohen sanksione përkatëse dhe / ose masa korrigjuese. Gjatë hetimit të vlefshmërisë së konstatimeve, KEDHP-ja mund të marrë parasysh edhe konstatimet e hetimeve të zbatuara nga nënkomitetet e veçanta (Investigative subcommittees - ISC), dhe natyrisht edhe materialet hetimore të marra nga KEK-u. KEDHP-ja vendos rast pas rasti nëse konstatimet dhe fazat e caktuara të procedurës do të bëhen të disponueshme për publikun, duke marrë parasysh kryesisht prezumimin e pafajësisë.

5.1.2 Komisioni i Etikës në Kongres

Me Rezolutën e DHP-së nga viti 2008 - Komisioni i Etikës në Kongres (KEK) u vendos si trup i pavarur për mbikëqyrjen e etikës dhe përgjegjësisë në Kongres, në bashkëngjitje të llogaridhënies dhe informacionit të disponueshëm publikisht, si trup i pavarur dhe jopartiak që është kompetent për shqyrtimin e parashtresave për sjelljen potencialisht joetike të deputetit, nëpunësit dhe të punësuarit në Dhomën e Përfaqësuesve. KEK-u punon sipas Kodit të tij të Sjelljes, ndërsa është kompetent për të zbatuar hetime për konstatimet e shkeljeve të ligjit, rregullës, rregullativës ose standardeve të tjera të sjelljes. Në këshillin e KEK-ut, të përbërë nga personat publikë jopartiakë, të cilët nuk mund as të përfaqësojnë grup të lobit dhe as të jenë nëpunës të Qeverisë Federale, hyjnë - gjashtë anëtarë dhe dy zëvendës, të deleguar me pëlqimin e



ndërsjellë të propozimeve të Kryetarit të DHP-së dhe liderit të pakicës në DHP. Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve emëron tre anëtarë (me të drejtë vote dhe kryesuesin e zgjedhur) dhe një zëvendës, ndërsa lideri i pakicës në DHP emëron tre anëtarë (me të drejtë vote dhe bashkëkryesuesin e zgjedhur) dhe një zëvendës. Kështu të ndarë, këshilltarët vendosin me shumicë votash mbi rezultatin e procedurës hetimore konkrete që kalon nëpër dy faza, e cila në shumicën e rasteve formohet në raportin e detajuar të prezantuar përpara KEDHP-së, i cili është i vetmi i autorizuar të vendosë qoftë për sanksionet, qoftë për refuzimin e procedurës së mëtejshme. Përveç kur KEK-u vendos në mënyrë të pavarur që në bazë të konstatimeve të dorëzuara nuk do të ngrit procedurë, ose se procedura në fazë të caktuar të hetimit duhet të ndërpritet, në të gjitha rastet e tjera KEDHP-ja duhet t'i bëjë publike konstatimet e hetimit të KEK-ut.¹⁴¹⁵

KEK-u nuk ka autorizime të përcaktojë shkeljen e legjislacionit të caktuar, as nuk ka autorizime të japë udhëzime juridike, as të propozojë ose të sanksionojë deputet, nëpunës ose të punësuar tjetër të DHP-së. Këto procedura janë në kompetencë të KEDHP-së. KEK-u është shërbim që i siguron, i kontekstualizon juridikisht, ua vlerëson rëndësinë e të dhënave për rastin e caktuar të sjelljes joetike të raportuar, ndërsa krejt këtë e publikon çdo tre muaj në raportin e disponueshëm publikisht. Nuk është në kompetencë të KEK-ut të shqyrtojë ankesa / parashtresa për sjelljen potencialisht joetike nga anëtarët e Senatit, Presidentit të SHBA-së ose nëpunësit e pushtetit ekzekutiv.

Përbërja e të punësuarve të rregullt në KEK kryesisht është nga avokatët dhe nga ekspertët e tjerë me përvojë të veçantë në fushat e etikës dhe hetimeve.

Hetimet që i mban KEK-u përbëhen nga dy faza, të emëruar thjesht - pasqyra fillestare dhe sekondare e hetimit. Të dy fazat duhet të aprovohen nga Këshilli i KEK-ut, ndërsa në fund të fazës fillestare Këshilli duhet të votojë për të konfirmuar nëse procedura hetimore do të vazhdojë. Në mënyrë që KEK-u të fillojë fazën fillestare, të paktën dy anëtarë të Këshillit, nga një prej dy palëve të përfaqësuara, duhet të theksojnë me shkrim "në bazë të arsyeshme" se konstatimet e marra për sjelljen joetike janë vërtetuar. Në fazën sekondare, përpara Këshillit prezantohen provat, ndërsa në mënyrë që kjo fazë të vazhdojë, të paktën tre anëtarë duhet të prononcohen se ekziston - "besueshmëri e caktuar e zbatimit të rastit", që sipas Kodit të KEK-ut do të thotë se - "ka prova të mjaftueshme për dyshimin e bazuar se deputeti, nëpunësi ose i punësuar ka kryer shkelje".

Faza fillestare e hetimit zgjat 30 ditë, gjatë së cilës të punësuarit në KEK i kontrollojnë aspektet juridike përkatëse mbi problematikën. Procedura ndërpritet nëse kundër saj votojnë 4 anëtarë të Këshillit. Faza sekondare është e kufizuar në 45 ditë, me mundësi, nëse është e nevojshme, për Këshillin ta vazhdojë edhe për 14 ditë shtesë.

Nëpunësit jopartiakë të KEK-ut sigurojnë prova dhe dëshmi përmes intervistave dhe përmes kërkesës për dorëzimin e dokumenteve të domosdoshme. Të gjitha provat e marra në këtë mënyrë i nënshtrohen Ligjit për dëshminë e rrejshme, i cili parashikon dënim penal për dëshminë e rrejshme ose për dokumentet e falsifikuara. Personit që

<https://oce.house.gov/about>

https://oce.house.gov/sites/congressionalethics.house.gov/files/documents/OCE_Code_of_Conduct_2011.pdf



është lëndë e hetimit, KEK-u në secilën fazë i dorëzon pasqyrë dhe vendim mbi përparimin e procedurës hetimore, ndërsa e njofton në kohën e duhur edhe kur Këshilli do të vendos që raporti mbi procedurën hetimore t'i dorëzohet KEDHP-së për shqyrtim të mëtejshëm dhe për vendimmarrjen përfundimtare për lëndën konkrete.

Në rast të votimit baraz, Këshilli mund që raportin përfundimtar t'ia dërgojë KEDHP-së si çështje e pazgjidhur. Këshilli, gjithashtu, mund informacionet në lidhje me sjelljen e pretenduar joetike t'i dorëzojë edhe te komisioni qeveritar, shërbimi ose trupi kompetent për veprim përkatës. Derisa zgjat procedura e provave dhe vendimmarrja e Këshillit - procedura hetimore është rreptësisht konfidenciale. KEDHP-ja është e detyruar që konstatimet e KEK-ut t'i publikojë brenda 45 ditëve, përveç nëse vendos të anulojë publikimin për 45 ditë shtesë, ose nëse vendos që për gjithë procedurën hetimore duhet të themelohet edhe nënkomiteti hetimor. Në atë rast, publikimi i raportit të KEK-ut mund të anulohet më së shumti deri në një vit. Nëse, nga ana tjetër, rasti konkret i lihet ndonjë institucioni shtetëror që përcaktohet si i pari kompetent, atëherë ai institucion mund të vendosë kur konstatimet e KEK-ut më në fund do të jenë të disponueshme publikisht.

5.1 Regjistrat e deklaratave / raporteve financiare

Nga regjistrat më të rëndësishëm që, në kontekstin e dispozitave të KSZ-së, i mban DHP-ja, janë - Regjistri i Deklaratave / Raporteve Financiare (RDR) dhe Regjistri i Kërkesave të Informacioneve të Klasifikuara (RIK). Për qartësi më të madhe, RDR-ja mbahet kryesisht në formularin elektronik, të përgatitur dhe të mirëmbajtur nga nëpunësi i caktuar posaçërisht, i ngarkuar dhe me kohë të dorëzojë postë elektronike të konfirmuar duke përkujtuar parashtresën se e ka përmbushur obligimin, ndërsa për informacione shtesë me nëpunësin mund të komunikohet edhe në numër të veçantë telefoni. Para se t'i mundësohet qasja në "informacionin e klasifikuar", deputetit, delegatit, komisionarit të përhershëm, nëpunësit ose të punësuarit në DHP i imponohet për atë nevojë të japë - "betim zyrtar". Me betimet, RIK-ja e mban sekretarin e zgjedhur posaçërisht, i cili kujdeset që regjistri të jetë publikisht i disponueshëm përmes arkivit digjital të DHP-së.

5.1 Parashtimi i ankesës

Informacionet për shkeljen e mundshme të KSZ-së në KEK vijnë nga burime të ndryshme, përfshirë edhe publikun e gjerë. Ankesat / parashtresat për sjelljen joetike të deputetit, nëpunësit ose të punësuarit tjetër të DHP-së në KEK parashtrihen në faqen e tij zyrtare të internetit duke plotësuar formularin e veçantë elektronik.



5.4 Sanksionet për shkeljen e KSZ¹⁶

Sanksionet që si masa disiplinore kundër deputetit, KEDHP-ja mund t'i rekomandojë përpara Dhomës së Përfaqësuesve (DHP) përfshijnë shkurtimin ose kufizimin e çfarëdo të drejte, fuqie, privilegji ose imuniteti nëse DHP-ja sipas Kushtetutës mund të ngrit sanksion të tillë. Në rastet ekstreme, KEDHP-ja mund të rekomandojë edhe - përjashtimin nga DHP-ja, si dhe qortimin dhe censurimin, përkatësisht marrjen e së drejtës për të diskutuar. KEDHP-ja mund t'i propozojë DHP-së edhe sanksioneve kundër nëpunësit ose kundër të punësuarit në Kongres, që do të thotë: - dorëheqja nga marrëdhënia e punës; - qortimi; - dënimi me të holla ose dënimi tjetër përkatës për peshën e shkeljes së konstatuar.

Sipas përvojës së bazuar në historinë e vet të gjatë, KEDHP-ja i përcakton propozimet për dënime për sjelljen joetike në lidhje me dispozitat e KSZ-së vetëm në bazë të shqyrtimit të hollësishëm të secilit rast veç e veç.

<https://ethics.house.gov/house-ethics-manual>

SHEMBUJ TË STRUKTURËS ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E KODEVE ETIKE

Shteti	Organi mbikëqyrës	Regjistrat e disponueshëm publikisht	Procedura ankimore	Sanksionet
Britania e Madhe	1. I autorizuari i standardeve <u>nëpunësi i pavarur, në formë të konkursit publik të zgjedhur nga Dhoma e Poshtme e Parlamentit</u> <u>Kompetencat:</u> - ofron këshilla / interpretime të Kodit të Sjelljes (KS); - heton konstatime nga ankuesi për shkeljen e mundshme të KS-së nga deputeti; - e njofton ankuesin dhe i bën thirrje deputetit për t'iu përgjigjur konstatimeve; - heton konstatime për ofendimet, për "ngacmimet" dhe / ose shqetësimin seksual në kuadër të Dhomës së Poshtme të Parlamentit; - vendosë në mënyrë të pavarur, por në kohën e duhur e njofton Komitetin e Standardeve që një rast i caktuar mund të zgjidhet me kërkimfalje me shkrim të dorëzuar nga deputeti në fjalë, ndërsa njoftimi të publikohet në faqen e internetit të të autorizuarit; - të monitorojë nevojën për të përshtatur përmbytjen e KS-së; - i mban regjistrat për përfitime financiare dhe përfitime të tjera të deputetëve në Dhomën e Poshtme; - jep raport në Komitetin e Standardeve.	Regjistrat e veçantë mbahen për përfitimin financiar (donacionet, honoraret, shpërblimet, dhuratat, etj.) dhe për përfitimin tjetër që e kanë marrë ose e marrin deputetët e Dhomës së Poshtme individualisht, ose grupe të caktuara parlamentare dhe / ose parti, por edhe kuadri i gazetarëve i ngarkuar për ndjekjen e punës së Kanalit të Kuvendit; Regjistrat janë në dispozicion publikisht në faqen e internetit të Dhomës së Poshtme të Parlamentit, ndërsa për mirëmbajtjen e tyre është i ngarkuar i autorizuari i standardeve. Mënyra në të cilën deputeti ose partia njofton për përfitimin e marrë (financiar) përkrahur me Rregulloren e veçantë.	<u>Ankesat duhet:</u> - të parashtrihen nga individ, qoftë deputet, qoftë person jashtë Parlamentit; - të jenë në formë me shkrim, të nënshkruara dhe të përmbajnë emrin dhe mbiemrin e plotë të ankuesit dhe adresën e tij të plotë postare; - të raportojnë qartë dhe me argumente në lidhje me shkeljen e mundshme të KS-së; - kopja e ankesës të dorëzohet te deputeti në fjalë.	- Komiteti i Standardeve shqyrton vazhdimisht llojet e sanksioneve për deputetët që kanë shkelur KS-në - duke pasur parasysh efektivitetin dhe drejtësinë e sanksionit të veçantë në lidhje me peshën e shkeljes së kryer; - me propozim të Komitetit dhe me vendim të Dhomës së Poshtme, fusha e sanksionit varion nga: kërkimfalja me gojë ose me shkrim, në - mospagimin e rrogës, përjashtimi ose largimi nga puna e Dhomës së Poshtme të Parlamentit; - deputeti për të cilin mbahet procedura për shkeljen e KS-së duhet të bashkëpunojë plotësisht me të autorizuarin dhe Komitetin. Përpjekja e deputetit për të lobuar te ndonjë nga anëtarët e Komitetit - konsiderohet shkelje shumë serioze e standardeve etike, ndërsa zakonisht përfundon me propozim për të pezulluar deputetin nga puna e Dhomës së Poshtme.

	2. <u>Komiteti i Standardeve</u> <u>përbërja: - 7 deputetë, të zgjedhur nga Dhoma e Poshtme, dhe 7 persona publikë (4 femra dhe 3 meshkuj) profesionistë të dëshmuar me fushëveprimin kryesisht (por jo ekskluzivisht) të të drejtave të njeriut, të zgjedhur në konkurs publik të shpallur nga Dhoma e Poshtme e Parlamentit;</u> <u>Kompetencat:</u> - e mbikëqyrë punën e të autorizuarit; - i shqyrton raportet e të autorizuarit për (mos)respektimin e KS-së; - prononcohet (sipas nevojës) për përmbajtjen e disa raporteve; - diskuton për raste të caktuara të kontroverseve financiare dhe kontroverseve të tjera; - bën thirrje për prononcim intern të deputetit ose liderit të partisë; - diskuton për raste të tjera të shkeljes së KS-së për të cilat njofton i autorizuari; - propozon, (sipas nevojës) ndryshime të KS-së; - vendos me konsensus, edhe pse lejohet shtimi i të a.q. - "mendimi i veçuar"; - konkluzionin e mbikëqyrjes e publikon në faqen e vet të internetit.			
Republika e Maltës	1. <u>I autorizuari i standardeve në jetën publike</u> <u>I autorizuari nuk duhet të jetë:</u> - deputet në përbërjen aktuale të Parlamentit; - këshilltar në vetëqeverisjen lokale; - nëpunës publik;	I mban Kryetari i Parlamentit, ndërsa janë në dispozicion publikisht përmes faqes së internetit të Parlamentit: - Regjistri i interesave financiare të deputetit (lloji - "lista anketuese");	Ankesa parashtrohet te i autorizuari i standardeve dhe mund të parashtrojë çdokush, ndërsa duhet: - të parashtrohet qoftë me letër, qoftë në formë elektronike;	Sanksionet ose masat disiplinore për sjelljen joetike zbatohen ekskluzivisht nga Komiteti i Përhershëm Parlamentar i Standardeve të Jetës Publike (KPS). Sanksionet:

- person shërbimi ose pozicioni i të cilit bie ndesh me Ligjin për standarde në jetën publike; - anëtar i sindikatës zeytare, bankare, tregtare ose sindikatës tjetër me pozicion pune të paguar; - emërohet për mandat pesëvjeçar - (pa të drejtë rizgjedhjeje, me të drejtë dorëheqjeje) nga Presidenti i Republikës së Maltës, ndërsa në bazë të rezolutës së miratuar nga Parlamenti me të paktën dy të tretat e përbërjes së përgjithshme parlamentare, i cili me të njëjtën procedurë, ndërsa me rrethana të caktuara, mund edhe të ndryshojë AS-në përpara se t'i skadojë mandati. <u>I autorizuari mund:</u> - të hapë procedurë hetimore me iniciativë të vet ose në bazë të ankesës / parashtrësës; - në procedurën hetimore të angazhojë persona profesionistë si konsulentë të jashtëm, dhe nëse personi profesionist i nevojshëm është nëpunës publik, atëherë për angazhimin e tij duhet të kërkojë miratimin nga Kryeministri. - t'i paraqesë konstatimet dhe t'i japë kohën e nevojshme për mbrojtjen juridike deputetit, ministrit, sekretarit të Parlamentit ose të autorizuarit qeveritar - nëse ka shkelur ligjin ose Kodin Etik; - të kontrollojë saktësinë e të dhënave në "listat anketuese", respektivisht - deklaratat e interesit financiar ose konfliktit të interesave që i parashtrojnë deputetët dhe ministrat; -	- Regjistri i deklaratave të konfliktit të mundshëm të interesave - detyrimisht të dhëna para fillimit të diskutimit parlamentar për ligj të caktuar; - Regjistri i deklaratave të udhëtimeve të bëra jashtë Maltës; - Regjistri i njoftimeve me shkrim të deputetit nën presion nga pala e tretë - për sjellje joetike dhe / ose përpjekja për korrupsion.	- në raste të jashtëzakonshme, ankesa mund të parashtrohet edhe me gojë, por më pas duhet të bëhet transkripti që deklaratë zyrtare do të harmonizohet dhe do të konfirmohet më së voni brenda dhjetë ditësh; - për ankesë me gojë, përmes numrit zyrtar të telefonit të Zyrës, caktohet takimi me të autorizuarin; - të përmbajë identitetin e plotë të parashtruesit (nëse dëshiron të mbetet anonim, ai duhet t'i a theksojë këtë të autorizuarit); - të theksohet identiteti i plotë i ankuesit, me arsyetim të shoqëruar shpjegues për sjelljen e mundshme joetike ose për shkeljen e kryer; - të parashtrohet brenda tridhjetë ditëve pune nga njohja fillestare e sjelljes joetike, ose më së voni një vit pasi vepra është kryer në të vërtetë - jashtë këtyre datave - i autorizuari nuk e merr parasysh ankesën;	- bazohen kryesisht në konstatimet e hetimeve të përfshira në raportin e të autorizuarit; - për deputetin, ministrin, sekretarin e Parlamentit, nëpunësit e tjerë parlamentarë dhe për të autorizuarit qeveritarë - përfshijnë: paralajmërim ose kërkesë për kërkimfalje zyrtare, por varësisht nga përmbajtja dhe nga pesha e shkeljes, Komiteti mund të parashtrojë kërkesë në institucionet shtetërore përkatëse, përfshirë edhe Parlamentin, për zgjidhje të mëtejshme juridike konsekuente të shkeljes; Nëse Komiteti nuk pajtohet me konstatimet e raportit të të autorizuarit, atëherë: - mund të vendosë që procedura të vazhdojë me hetim të mëtejshëm; - mund që plotësisht të refuzojë raportin e të autorizuarit, me ç'rast duhet të arsyetojë publikisht pse ka marrë vendim të tillë.
---	---	--	---

	- të japë rekomandime për përmirësimin e teksteve të disa prej kodeve etike, si dhe rregullativave për lobimin dhe për pranimin e dhuratave. - - të hartojë raport që më pas në Parlament e parashtron përpara Komitetit të Përhershëm të Standardeve në Jetën Publike. <u>I autorizuari nuk mund</u> - të hetojë raste të sjelljes joetike që janë lëndë e ndjekjes penale ose janë tashmë në procedurën policore. 2. <u>Komiteti i Përhershëm i Standardeve në Jetën Publike</u> përbërja: katër anëtarë / deputetë: - dy nga shumica qeveritare dhe dy nga opozita; kryesues është Kryetari i Parlamentit, vota e të cilit është vendimtar në rast të votimit baraz. <u>Kompetencat:</u> - e mbikëqyr punën e të autorizuarit të standardeve - i shqyrton raportet që i autorizuari i parashtron pas hetimit të zbatuar për sjelljen joetike të deputetit, ministrit, të autorizuarit qeveritar, nëpunësit publik dhe / ose sekretarit të Parlamentit.		<u>Ankesa refuzohet:</u> - nëse është tashmë lëndë e procesit gjyqësor rrjedhës ose procedurës përpara tribunalit, nëse është ngritur proces përpara gjykatës për shkelje ose në rastin e hetimit rrjedhës në kompetencë të policisë. - I autorizuari me arsyetim me shkrim e njofton parashtruesin, nëse konsideron se ankesa është: - e pabazuar; - e parëndësishme; - arbitrare; - e pajustificueshme dhe / ose - qëllimkeqe.	
	1. <u>Byroja e Kuvendit</u> përbërja: - 10 anëtarë, kryesues është Kryetari i Kuvendit, ndërsa anëtarët e tjerë janë -	<u>Regjistri për konfliktin e interesave</u> – mbahet nga shërbimi i veçantë i Kuvendit, ndërsa adresa e fundit	Ankesat për shkeljen e KS-së parashtrohen në adresën e Byrosë së Kuvendit, ndërsa mund t'i parashtrrojë grupi	BK-ja diskuton mbi shkallën e shkeljes së KS-së potencialisht të kryer nga deputeti i caktuar, me ç'rast, për të përcaktuar llojin e sanksionit të mundshëm, të përshkruar në

Republika e Shqipërisë	zëvendëskryetari i Kuvendit dhe përfaqësuesit e sekretariateve parlamentare; Pas takimit të punës me <u>Sekretariatit e Procedurave, Votimit dhe Etikës</u> (i përbërë nga 5 anëtarë të emëruar nga Kuvendi me votim të hapur, me propozim të Kryetarit të Kuvendit dhe pas konsultimeve me kryetarët e grupeve parlamentare), BK-ja mund të analizojë raste specifike të sjelljes së deputetit të caktuar, në lidhje me: <u>Kompetencat:</u> - keqpërdorimin e pozitës politike, ndërsa kundër nderit dhe reputacionit të "deputetit" si përfaqësues i Kuvendit; - dorëzimin e formularëve të gabuar për gjendjen financiare dhe përfitimet e tjera sipas Kodit të Sjelljes; - nxitjen e formave joetike të keqpërdorimit të votuesve. 2. <u>Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Çështjeve të Imunitetit (KRRMC)</u> - trup këshillëdhënës për çështjet që lidhen me procedurën sipas së cilës Kuvendi funksionon dhe miraton vendime; <u>përbërja: Kryetari i Kuvendit, si kryesues i tij, emëron 10 deputetë bazuar në mendimin e marrë nga kryetarët e grupeve parlamentare.</u> <u>Kompetencat:</u>	meritore për vlerësimin e vërtetësisë së të dhënave nga Regjistri është - Byroja e Kuvendit;	parlamentar, por edhe organizatat e jashtme dhe / ose individët; <u>Ankesa përbëhet nga:</u> përshkrimi me shkrim i rastit, por edhe nga dokumentacioni tjetër shoqërues audio / vizual i bashkangjitur në procedurën e provave;	detaje dhe të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit, i merr parasysh edhe të dhënat nga Regjistri i masave disiplinore, kryesisht për të përcaktuar nëse deputeti përsërit sjellje të dëmshme për reputacionin publik të Dhomës Ligjvënëse. Llojet e ndryshme të sanksioneve, ose - masat disiplinore, parashikohen me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Mund t'i shqiptohen deputetit i cili në mënyra të ndryshme, qoftë verbalisht, qoftë fizikisht, e pengon punën e seancave plenare dhe seancave parlamentare, ose, me sjelljen e tij publike, e dëmton reputacionin e institucionit. Në mënyrë të tërthortë, në fazat e të gjithë procedurës disiplinore, mund të përfshihen edhe Sekretariati Teknik dhe Sekretariati i Procedurave dhe Votimit, nëse është e nevojshme dhe në përputhje me kompetencat e tyre. Masat disiplinore ndahen në "të lehta" dhe "të rënda", ndërsa kuptimi dhe procedura për zbatimin e secilës masë veç e veç - janë shtjelluar dhe shpjeguar në detaje në Rregulloren e Kuvendit. Në "masat e lehta", pa të drejtë ankese, parashihen: • përjashtimi i përkohshëm nga diskutimi parlamentar; • paralajmërimi; • marrja e së drejtës për të folur gjatë seancës plenare ose mbledhjes së komisionit;
--------------------------------------	---	---	---	---

	- e vlerëson - periodikisht e (ri)vlerëson dhe e revidon Kodin e Sjelljes (KS); - <u>i shqyrton:</u> - o materialet e veçanta dhe raportet vjetore të BK-së, në lidhje me rastet e shkeljes së KS-së, si dhe masat disiplinore të marra kundër deputetëve për këto shkelje; - o përshkrimet e rasteve të shkeljes së KS-së gjatë mandatit legjislativ; - o regjistrin e masave disiplinore; - o jurisprudencën shqiptare, si dhe ndryshimet në legjislacionin shqiptar për çështjet e përfshira me KS-në; - o praktikën ndërkombëtare për këto çështje; - o përgatit raport që prezantohet në seancë plenare (raporti nuk është lëndë e diskutimit të mëtejshëm parlamentar, por Kuvendi e miraton më së voni një muaj pas prezantimit); Më së voni tetë muaj para skadimit të mandatit të përbërjes parlamentare, Kryetari i Kuvendit konvokon mbledhje të KRRMI-së në të cilën janë të ftuar edhe përfaqësuesit e organizatave civile dhe grupeve të interesit, të evidentuar në regjistër të veçantë parlamentar për lobim në favor të shoqërisë civile.			Në "masat e rënda", me të drejtë ankese, përfshihen: • përjashtimi nga seanca plenare, nga mbledhja e komisionit ose trupit tjetër të Kuvendit; • përjashtimi deri në 10 ditë nga pjesëmarrja në seancën plenare, nga komisionet parlamentare dhe nga trupat e tjerë të Kuvendit; Incidenti i caktuar mund të kalojë me paralajmërim me gojë të deputetit, por nëse ajo masë disiplinore rezulton joefikase, atëherë Kryetari i Kuvendit miraton vendim për përjashtimin e deputetit nga sesioni, duke formuluar vendimin në lëndë të veçantë interne që e prezanton përpara BK-së, zakonisht me rekomandim për masa më të rrepta disiplinore. Vendimet e BK-së në bazë të shkeljes së KS-së publikohen në faqen e internetit të Kuvendit.
	1. Këshilli i Etikës (KE) - trup në kuadër të Parlamentit të Republikës së Gjeorgjisë;	Faqja zyrtare e internetit e Parlamentit përmban: - Regjistrin e grupeve të autorizuara të lobit, në	Ankesa dorëzohet në formular të veçantë - qoftë elektronike, qoftë me kopje fizike, të paraqitur qoftë individualisht nga deputeti, qoftë nga grupi	Tani për tani, përveç njoftimit publik të identitetit të shkelësit të dispozitave të KS-së për të cilat KE-ja e ka kompetencën e parë, sanksione të tjera nuk janë parashikuar. Kjo është vërejtja kryesore nga

Republika e Gjeorgjisë	përbërja: Komiteti për Çështje Procedurale dhe Rregulloren e Parlamentit i përcaktojnë kuotat për përfaqësimin proporcional të partive në përbërjen e KE-së, më së voni një javë pas miratimit të dekretit për përbërjen e re parlamentare. Byroja e Kuvendit i konfirmon kuotat për anëtarët e KE-së, ndërsa mandati zgjat një vit. KE-në e mbajnë dy bashkëkryesues, të zgjedhur në mënyrë interne nga anëtarët e tjerë të KE-së - një nga shumica qeveritare dhe një nga partia më e madhe opozitare, por bashkëkryesuesi mund të delegohet edhe nga grupi parlamentar që nuk është i bashkuar as me shumicën qeveritare, as me opozitën. Numri i anëtarëve në KE ndryshon në varësi të shpërndarjes së deputetëve në grupe parlamentare në përbërjen ekzistuese parlamentare aktuale, si dhe nga numri i deputetëve të pavarur. <u>Kompetencat:</u> KE-ja ka autorizime të kërkojë informacione në lidhje me rastin e sjelljes joetike të deputetit, ndërsa i dyshuari është i detyruar të bashkëpunojë gjatë gjithë procedurës. Mbledhjet e KE-së janë të mbyllura për publikun, përveç në rastet kur të dy anëtarët e tij - dhe shumica qeveritare dhe opozita - nuk vendosin ndryshe. KE-ja është e detyruar të publikojë vendimin e vet në faqen e internetit të Parlamentit. KE-ja e mbikëqyr sjelljen e deputetit kur: - e keqpërdor pozicionin politik për përfitimin e vet personal dhe / ose përfitimin e familjes së tij dhe të të afërmeve të ngushtë (përkufizimi i këtyre nocioneve është marrë nga Ligji kundër konfliktit të interesave dhe kundër korrupsionit në shërbimin publik); - nuk parashtron deklaratë me shkrim, e cila publikohet në faqen e internetit të Parlamentit, para fillimit të diskutimit parlamentar në të	përputhje me Ligjin për aktivitetet e lobimit. - Regjistrin e konfliktit të mundshëm të interesave; - Regjistrin për shkeljen e dispozitave të KS-së; - Regjistrin e dhuratave.	parlamentar, por ankesë mund të parashtrojë çdo person që konsideron se në dëm të tij është shkelur ndonjë normë etike e KS-së; <u>KE-ja e shqyrton ankesën:</u> - nëse dorëzohet brenda një muaji pas zbulimit të të dhënës / ngjarjes së caktuar që është shkelje e mundshme e KS-së, e kryer nga deputeti me mandatin rrjedhës; - dhe prononcohet me vendim më së voni brenda një muaji, ndërsa fillimi i diskutimit për ankesën caktohet më së voni pas 5 ditësh pasi të jetë dorëzuar; nëse përcaktohet se ankesa nuk është në kompetencën e KE-së, atëherë ankuesi do të njoftojë me kohë për ta riadresuar te organi përkatës; deputeti të cilit i referohet ankesa informohet menjëherë për përmbajtjen e ankesës, i jepen 10 ditë pune për të përgatitur përgjigje dhe i jepen edhe 5 ditë shtesë nëse dorëzon letër me shpjegim të arsyeshëm për anulimin e përgjigjes.	kritikat e iniciativave civile në lidhje me KS-në ekzistuese. Në rastet e keqpërdorimit të konstatuar financiar ose penal të funksionit deputet, deputeti përgjigjet në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Gjeorgjisë.
--------------------------------------	--	--	--	--

	cilin e dinte se po merrte pjesë me konflikt të mundshëm të interesave; - nuk paraqet dhuratë / shpërblim në shumën / vlerën e 300 liri gjeorgjiane (rreth 70 euro), për të cilat Sekretariati i KE-së mban Regjistër të veçantë të dhuratave, i disponueshëm në faqen e internetit të Parlamentit; - lobon gjatë mandatit të tij, edhe pse e di që nuk duhet; - pranon dhurata / shpërblime nga grupet e lobit, edhe pse e di që nuk duhet; - nuk njofton për takimet e biznesit me grupet e lobit, dhe nuk parashtron deklaratë në lidhje me takimin e tillë, që publikohet në faqen e internetit të Parlamentit; - në lidhje me kolegët dhe të punësuarit e tij në Parlament - diskriminon në bazë të - racës, etnisë, gjinisë, besimit fetar ose në bazë të përcaktimeve të tjera personale / kolektive; - nuk siguron informacion për kontaktin zyrtar personal; nëse normat e KS-së shkelen nga anëtari i KE-së, atëherë atij i merret e drejta për të diskutuar dhe votuar në KE, ndërsa grupi parlamentar që e delegoi përkohësisht e zëvendëson me delegat tjetër, derisa të zbardhet rasti.			
SHBA	Në Kongresin e SHBA-së - Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve kanë trupa të veçantë të mbikëqyrjes për sjelljen etike të anëtarëve të tyre, të nëpunësve dhe të të punësuarve të tjerë në këto institucione shtetërore.	Regjistrat më të rëndësishëm në kontekstin e dispozitave të KSZ-së i mban Dhoma e Përfaqësuesve, ndërsa veçohen:	Informacionet për shkeljen e mundshme të KSZ-së në KEK vijnë nga burime të ndryshme, përfshirë edhe publikun e gjerë. Ankesat / parashtrës për	Sanksionet / masat disiplinore që kundër deputetit, <u>KEDHP-ja mund t'i rekomandojë përpara Dhomës së Përfaqësuesve</u> përfshijnë - shkurtimin ose kufizimin e çdo të drejte, fuqie, privilegji ose imuniteti nëse

	Kjo tabelë i paraqet vetëm kompetencat e të dy trupave për mbikëqyrjen e sjelljes etike në Dhomën e Përfaqësuesve: - <u>Komiteti i Etikës në Dhomën e Përfaqësuesve (KEDHP) dhe Komisioni i Etikës në Kongres (KEK).</u> 1. Komiteti i Etikës në Dhomën e Përfaqësuesve (KEDHP) <u>është këshill i përhershëm dhe ka autorizime për të interpretuar, menaxhuar dhe realizuar "Kodin e Sielljes Zyrtare në Dhomën e Përfaqësuesve" (KSZ), për përmbajtjen e të cilit i trajnon deputetët, nëpunësit dhe të punësuarit në Kongres, dhe është i autorizuar, nëse është e nevojshme, kundër tyre të mbajë hetime dhe të sanksionojë raste të sielljes joetike;</u> përbërja: - në këshillin e përhershëm të KEDHP-së delegohen 5 përfaqësues nga republikanët dhe 5 nga demokratët, kryesues tradicionalisht zgjidhet ai që ka më shumë përvojë nga radhët e shumicës qeveritare, ndërsa puna e tij e përditshme kryhet nga nëpunësit jopartiakë, sipas sistematizimit të ndarë në: - këshilltari kryesor; - këshilltari i kryesuesit; - këshilltari i anëtarëve të komitetit; - drejtori i administratës; - drejtori i Departamentit të Hetimeve; - drejtori i deklaratave / raporteve financiare; - drejtori i këshillimit dhe arsimit; - këshilltari i lartë; - këshilltari; - kërkuesi / hetuesi; - nëpunësi dhe personalitet ndihmës. Kompetencat: - vendos rregulla që e rregullojnë sjelljen e deputetëve në lidhje me - dhuratat, udhëtimet, aktivitetet në fushatën politike, konfliktin e interesave, marrëdhënien ndaj të punësuarve në Kongres, etj;	▪ Regjistri i deklaratave / raporteve financiare (RDR); ▪ Regjistri i kërkesave të informacioneve të klasifikuara (RIK); për qartësi më të madhe, RDR-ja mbahet kryesisht në formularin elektronik, të përgatitur dhe të mirëmbajtur nga nëpunësi i caktuar posaçërisht, i ngarkuar dhe me kohë të dorëzojë postë elektronike të konfirmuar duke përkujtuar parashtruesin se e ka përmbushur obligimin, ndërsa për informacione shtesë me nëpunësin mund të komunikohet edhe në numër të veçantë telefoni. para se t'i mundësohet qasja në "informacionin e klasifikuar", deputetit, delegatit, komisionarit të përhershëm, nëpunësit ose të punësuarit në DHP i imponohet për atë nevojë të japë - "betim zyrtar". Me betimet, RKI-në e mban sekretari i zgjedhur posaçërisht, i cili kujdeset që regjistri të jetë publikisht i disponueshëm përmes arkivit digjital të DHP-së.	sjelljen joetike të deputetit, nëpunësit ose të punësuarit tjetër të DHP-së në KEK parashtrihen në faqen e tij zyrtare të internetit duke plotësuar formularin e veçantë elektronik.	DHP-ja mund të ngrit sanksion të tillë sipas Kushtetutës. Në rastet ekstreme, <u>KEDHP-ja mund të rekomandojë</u> dhe - dëbimin nga Dhoma e Përfaqësuesve, si dhe qortimin dhe censurimin, përkatësisht marrjen e së drejtës për të diskutuar. KEDHP-ja mund t'i propozojë DHP-së edhe sanksioneve kundër nëpunësit ose kundër të punësuarit në Kongres, që do të thotë: - dorëheqja nga marrëdhënia e punës; - qortimi; - dënimi me të holla ose dënimi tjetër përkatës për peshën e shkeljes së konstatuar.
--	--	---	---	--

	- me iniciativën e vet ngrit hetime nëse deputetët në DHP i zbatojnë standardet e KSZ-së; - i jep rekomandime DHP-së në lidhje me veprimet e nevojshme që do të ndërmerren pas hetimit të kryer; - jep këshilla për deputetët në DHP përpara se të ndërmarrin veprim të caktuar që mund të jetë në kundërshtim me standardet etike; - KEDHP-ja është e detyruar që konstatimet e KEK-ut t'i publikojë brenda 45 ditëve, përveç nëse vendos të anulojë publikimin për 45 ditë shtesë, ose nëse vendos që për gjithë procedurën hetimore duhet të themelohet edhe nënkomiteti hetimor. Në atë rast, publikimi i raportit të KEK-ut mund të anulohet më së shumti deri në një vit. - përpara organeve dhe institucioneve federale ose shtetërore përkatëse paraqet prova të verifikuara kundër deputetit për të cilin vlerësohet se ka shkelur me shumë gjasë rregullativën e caktuar ligjore. <u>2. Komisioni i Etikës në Kongres (KEK)</u> <u>trup i pavarur për mbikëqyrjen e etikës dhe përgjegjësisë në Kongres, në bashkëngjitur të llogaridhënies dhe informacionit të disponueshëm publikisht, si trup i pavarur, jopartiak që është kompetent për rishqyrtimin e ankesave për sjelljen potencialisht joetike të deputetit, nëpunësit dhe të punësuarit në Dhomën e Përfaqësuesve. KEK-u punon sipas Kodit të tij të Sjelljes, ndërsa është kompetent për të zbatuar hetime për konstatimet e shkeljeve të ligjit, rregullës, rregullativës ose standardeve të tjera të sjelljes.</u>			
--	---	--	--	--

	përbërja: në Këshillin e KEK-ut, të përbërë nga personat publikë jopartiakë, të cilët nuk mund as të përfaqësojnë grup të lobit dhe as të jenë nëpunës të Qeverisë Federale, hyjnë - gjashtë anëtarë dhe dy zëvendës, të deleguar me pëlqimin e ndërsjellë të propozimeve të Kryetarit të DHP-së dhe liderit të pakicës në DHP. Kryetari i DHP-së emëron tre anëtarë (me të drejtë vote dhe kryesuesin e zgjedhur) dhe një zëvendës, ndërsa lideri i pakicës në DHP emëron tre anëtarë (me të drejtë vote dhe bashkëkryesuesin e zgjedhur) dhe një zëvendës. Të ndarë kështu, këshilltarët vendosin me shumicë votash për rezultatin e procedurës hetimore konkrete që kalon nëpër dy faza dhe më pas formohet në raport të detajuar të prezantuar përpara <u>KEDHP-së, i cili është i vetmi i autorizuar të vendosë qoftë për sanksionet, qoftë për refuzimin e procedurës së mëtejshme</u>; përbërja e të punësuarve të rregullt në KEK kryesisht është nga avokatët dhe nga ekspertët e tjerë me përvojë të veçantë në fushat e etikës dhe hetimeve. <u>Kompetencat:</u> ▪ KEK-u nuk ka autorizime të përcaktojë shkeljen e legjislacionit të caktuar, as nuk ka autorizime të japë udhëzime juridike, as të propozojë ose të sanksionojë deputet, nëpunës ose të punësuar tjetër të DHP-së. Këto procedura janë në kompetencë të KEDHP-së; ▪ KEK-u është shërbim që i siguron, i kontekstualizon juridikisht, ua vlerëson rëndësinë e të dhënave për rastin e caktuar të sjelljes joetike të paraqitur, ndërsa krejt këtë e publikon çdo tre muaj në raportin e disponueshëm publikisht;			
--	---	--	--	--

	▪ nuk është në kompetencë të KEK-ut të shqyrtojë ankesa / parashtresa për sjelljen potencialisht joetike nga anëtarët e Senatit, Presidentit të SHBA-së ose nëpunësve të pushtetit ekzekutiv; ▪ hetimet që i mban KEK-u janë rreptësisht konfidenciale dhe përbëhen nga dy faza, të emëruara thjesht - pasqyra fillestare dhe sekondare e hetimit. Të dy fazat duhet të aprovohen nga Këshilli i KEK-ut, ndërsa në fund të fazës fillestare Këshilli duhet të votojë për të konfirmuar nëse procedura hetimore do të vazhdojë. ▪ "të dyshuarit", KEK-u në secilën nga fazat e hetimit i dorëzon pasqyrë dhe vendim mbi përparimin e procedurës, ndërsa me kohë e njofton edhe kur Këshilli do të votojë që raporti i procedurës hetimore duhet t'i dorëzohet KEDHP-së për shqyrtim të mëtejshëm dhe për vendimmarrje përfundimtare për lëndën konkrete; ▪ në rast të votimit baraz, Këshilli mund të dërgojë raportin përfundimtar në KEDHP si çështje e pazgjidhur; ▪ Këshilli i KEK-ut mund t'i dërgojë informacionet në lidhje me sjelljen joetike edhe te komisioni tjetër qeveritar, shërbimi ose trupi kompetent për veprim përkatës; ▪ nëse rasti konkret i lihet ndonjë institucioni shtetëror që përcaktohet si i pari kompetent, atëherë ai institucion mund të vendosë kur konstatimet e KEK-ut më në fund do të jenë të disponueshëm publikisht.			
--	---	--	--	--